

LABORATOR 1

Tema: Ambjenti i punës në Excel, formatimi i teksteve, radhitja dhe bashkimi i qelizave, krijimi dhe formatimi i tabelave, formatimi i qelizave; puna me workbooks dhe worksheet, insertimi i objekteve, formulat llogaritëse dhe funksionet e gatshme në Excel

OPERATORËT ARITMETIKË

+ Addition (Mbledhja); - Subtraction (Zbritja); * Multiplication (Shumëzimi); / Division (Pjesëtimi)
^ Exponential (Ngritja në Fuqi)

USHTRIMI 1-MBLEDHJA

1. Shtyp tekstin **Add** në qelizën A1. Shtyp tastën Enter.
2. Shtyp numrin **1** në qelizën A2. Shtyp tastën Enter.
3. Shtyp numrin **1** në qelizën A3. Shtyp tastën Enter.
4. Shtyp formulën **=A2+A3** në qelizën A4. Shtyp tastën Enter.

Excel do të mbledhë përmbajtjen qelizave A2 dhe A3 dhe rezultatin do e vendosë në qelizën A4. Formula afishohet edhe në Formula bar.

USHTRIMI 2- ZBRITJA

1. Shtyp tastën F5. Dritarja **Go To** do të afishohet. Shtyp **B1** në fushën Referencë. Shtyp tastën Enter.
2. Shtyp tekstin **Subtract**. Shtyp tastën Enter.
3. Shtyp **6** në qelizën B2. Shtyp tastën Enter.
4. Shtyp **3** në qelizën B3. Shtyp tastën Enter.
5. Shtyp formulën **=B2-B3** në qelizën B4. Shtyp tastën Enter.

USHTRIMI 3- SHUMËZIMI

1. Mbani të shtypur njëkohësisht tastën Ctrl dhe gërmën "g" (Ctrl+g). Dritarja Go To do të afishohet.
2. Shtyp **C1** në fushën Reference. Shtyp tastën Enter.
3. Shtyp tekstin **Multiply**. Shtyp tastën Enter.
4. Shtyp **2** në qelizën C2. Shtyp Enter.
5. Shtyp **3** në qelizën C3. Shtyp tastën Enter.
6. Shtyp formulën **=C2*C3** në qelizën C4. Shtyp tastën Enter.

USHTRIMI 4- PJESTIMI

1. Shtyp tastën F5. Shtyp **D1** në fushën Referencë. Shtyp tastën Enter.
2. Shtyp tekstin **Divide**. Shtyp tastën Enter.
3. Shtyp **6** në qelizën D2. Shtyp tastën Enter.
4. Shtyp **3** në qelizën D3. Shtyp tastën Enter.
5. Shtyp formulën **=D2/D3** në qelizën D4.

Të gjitha shembujt e formulave të mëposhtme janë të vlefshme:


=A2/B2

=A1+12-B3

=A2*B2+12


=24+53


USHTRIMI 5 – Butoni AutoSum



1. Shko në qelizën F1. Shtyp **3**. Shtyp tastën Enter.
2. Shtyp **3**. Shtyp tastën Enter. Shtyp **3**. Shtyp tastën Enter.
3. Zgjidh menunë Home tab.
4. Kliko në butonin AutoSum  në qelizën F4. Excel zgjedh qelizat F1 deri në F3 dhe llogarit Shumën në F4.

Ushtrimi6–Rradhitja e tekstit, Qendërimi I tekstit në qelizë

Për të qendëruar përmbajtjen e qelizave A1 deri D1 veprimë si më poshtë:



Selektojmë qelizat nga A1 deri në D1. Zgjedhim menyën Home. Klikojmë në butonin e qendërimit . Njëlloj veprimë edhe me butonat e tjerë:

-  Left-Align – rradhit tekstin majtas
-  Right-Align – rradhit tekstin djathtas

Ushtrimi7– Shprehjet aritmetike

1. Shko në qelizën A7.
2. Shtyp formulën $=3+3+12/2*4$.
3. Shtyp tastën Enter.

Fillimisht Exceli pjeston 12 në 2, më pas rezultatin e shumëzon me 4, e mbledh me 3 dy herë dhe në qelizën A7 rezultati përfundimtar do të jetë 30.

A7		fx = $=3+3+12/2*4$			
	A	B	C	D	E
7	30				
8					


Për të ndryshuar rradhën e veprimeve përdorim kllapat rumbullakë të cilat ekzekutohen të parat.

1. Double-click në qelizën A7.
2. Vendosim kllapat si në formulë: $=(3+3+12)/2*4$.
3. Shtypim tastën Enter.


Tani fillimisht Exceli mbledh 3, 3, 12, më pas e pjeston rezultatin me 2 dhe në fund e shumëzon me 4. Rezultati përfundimtar është 36, i cili paraqitet në qelizën A7.

A7		fx = $=(3+3+12)/2*4$			
	A	B	C	D	E
7	36				
8					


Ushtrimi 7–Bold, Italic, simple & double Underline



1. Përdorim i butonit bold **B**.





2. Përdorim i butonit italic *I*.



1. Përdorimi butonit underline U.

Double Underline



1. Përdorimi butonit duple underline .


Shortcut Keys

Bold- Ctrl+B


Italic -(Ctrl+i).

Underline- (Ctrl+u)


Ushtrimi 8. Ndryshimi I gjerësisë së shtyllës




1. Vendosni kursorin në qelizën A1. Shkruaj tekstin: Sot është e dita e parë në Excel.
2. Zgjidh menynë Home.
3. Kliko butonin Format.
4. Zgjidh **Column Width**. Dritarja **Column Width** do ju paraqitet.
5. Shtyp **55** në fushën Column Width.
6. Kliko OK. Gjerësia e kollones tani është 55.




Ushtrimi 9 –Formatimi i numrave



1. Shko në qelizën B8.
2. Shtyp **1234567**.
3. Shtyp tastën Enter.




4. Zgjidh menyën Home.
5. Kliko në butonin Number Format box. (shiko figurën)
6. Zgjidh Number.



7. Kliko butonin Comma Style , dhe Exceli e ndan numrin në mijëshe me presje.
8. Kliko butonin Accounting Number Format $\text{\$}$ dhe Excel shton shenjën e dollarit para numrit.
9. Kliko dy herë në butonin Increase Decimal +0.00 për të ndryshuar pjesëndhjetore në 4 shifra.
10. Kliko butonin Decrease Decimal -0.00 nëse ju doni të zvogëloni shifrat e pjesës dhjetore.

Ndryshimi nga numër në përqindje

1. Shko në qelizën B9. Shtyp numrin 0.35. Shtyp tastën Enter.
4. Zgjidh menyën Home.
5. Kliko butonin Percent Style $\%$ dhe Excel i konverton numrin në %.



Ushtrimi 10

Krijoni një document në Excel me emrin "Informatika"

Krijoni 5 fleta pune (sheet1,...,sheet5) dhe riemëroini (A, B, C, D, E)

Për të gjithë qelizat zgjidhni fontin Century Gothic, **Bold**, me centrim në qendër (**Centered**).

Krijoni një tabelë në Excel në fletën e punës me emër A, në pozicionin A4 - G10.

Hijëzo me çfarëdo lloj ngjyre titullin e tabelës A4 -G4

Vendosni komentin "informatika" në qelizën G10

Bëje Merge (bashko qelizat) në rreshtin A10 -F10 dhe shkruaj "Gjithsej"

Në kolonën A5 deri në A9 shkruaj numrat (5, 10, 15, 20, 25) dhe A4 emërtoje vlera 1

Në kolonën B5 deri në B9 shkruaj numrat (10, 100, 1000, 10000, 100000) dhe B4 emërtoje vlera 2

Shumëzo qelizat A5 * B5 deri në A9 * D9 dhe vendos rezultatin në C5 deri në C9 dhe C4 emërtoje prodhimi.

Kolonën D formato për Datë dhe shkruaj disa data, emërto D4 Date

Në kolonën E5 deri në E9 shkruaj emrat e grupeve (A, B, C, D, E) dhe E4 emërtoje Grupe

Në kolonën F5 deri në F9 shkruaj numrat (17,800.00, 14,320.00, 20,870.00, 19,650.00, 11,340.00) dhe F4

Emërtoje shuma

Kolonën G formato për monedhë me shenjën e \$ (vendos dy decimale, mijëshe) dhe G4 emërtoje shuma në \$

Gjej shumën në G10

Prezanto grafikisht me tipin e Grafikut - **Pie**- të dhënat nga E5 deri në F9 dhe vlerat të jenë përqindje.

Pasi të keni krijuar grafikun tek **Chart Title**- Shkruaje "Grafiku im i parë".

